



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 15 tetor 2010
Nr. ref.: RK 49/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 18/09

Reshat Karanxha

kundër

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në përbërje të:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare dhe
Iliriana Islami, Gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi është Z. Reshat Karanxha, me banim në Prizren.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është Këshilli Gjyqësor i Kosovës i Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm "KGJK").

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy

Objekti i çështjes

3. Më 3 qershor 2009, parashtruesi ka dorëzuar një Kërkesë në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtutjeshëm "Gjykata") duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij themelore, që janë të garantuara me Kushtetutë, dhe në veçanti që Neni 49 (e drejta e punës) është shkelur nga KGJK dhe nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtutjeshëm "PSSP"). Kjo për faktin se KGJK ka tërhequr rekomandimin e saj ndaj PSSP për emërimin e tij në pozitën e Gjyqtarit për Kundërvajtje në Gjykatën Komunale në Prizren, edhe pse Kuvendi i Kosovës tashmë kishte miratuar rekomandimin e KGJK për emërimin e tij më 21 shtator 2006.

Baza juridike

4. Neni 113 (7) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Kushtetuta"); Neni 22 (7) dhe (8) i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm "Ligji"), dhe Neni 54(b) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Rregullorja e Punës").


Procedura para Gjykatës

5. Më 3 qershor 2009, parashtruesi ka dorëzuar një Kërkesë në Sekretariatën e Gjykatës.
6. Nëpërmjet letrës së 27 majit 2010, Gjyqtari Raportues, i caktuar për rastin, ka pyetur parashtruesin nëse ai ka ndërmarr ndonjë hap për të korrigjuar kaluarën penale. Në përgjigjen e tij, parashtruesi ka deklaruar që Gjykata Komunale në Prizren nuk ka ndonjë regjistër të dënimit të tij nga viti 1986. Prandaj, sipas mendimit të parashtruesit, nuk ka ndonjë dosje të gjykatës që duhet korrigjuar.
7. KGJK, së cilit i është komunikuar Kërkesa, nuk ka paraqitur komentet ndaj kërkesës.
8. Edhe pse i është kërkuar nga Gjyqtari Raportues, Gjykata Komunale në Prizren nuk ka verifikuar nëse ka ndonjë dosje të gjykatës për dënimin e parashtruesit më 15 janar 1986 (Aktgjykimi 317/82).
9. Megjithatë parashtruesi ka dorëzuar një provë nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kroacisë, e datës 25 janar 2008, që vërtetonte se ai nuk është dënuar. Më tutje, ai ka paraqitur një komunikatë nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Serbisë (Ministria e Punëve të Brendshme, Administrata Policore në Prizren 09 Nr. 235-304/06, lëshuar më 17.10.2006, IKM Krushevc) që konfirmonte se ai nuk është dënuar. Përveç kësaj, Gjykata Komunale në Ferizaj ka lëshuar një deklaratë më 26 mars 2009 me atë të së cilës vërtetohet që Parashtruesi nuk është dënuar për ndonjë vepër penale të dënueshme me tri (3) vjet burg apo gjobë.
10. Më 14 qershor 2010, pas shqyrtimit të Raportit të Gjyqtarit Raportues Robert Carolan, Kolegji Shqyrtues, i përbërë prej Gjyqtarëve Snezhana Botusharova (Kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Cukalovic, i rekomanduan Gjykatës së plotë lidhur me papranueshmërinë e Kërkesës.

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy

Faktet

11. Në qershor të vitit 2006, KGJK-ja i rekomandoi PSSP-së emërimin e 22 personave, që me sukses kishin përfunduar Programin Ndërkombëtar për Udhëheqje (ILEP), në pozitën e gjyqtarëve. Parashtruesi ishte një prej atyre personave.
12. Më 21 shtator 2006, Kuvendi i Kosovës fillimisht miratoi emërimin e parashtruesit në pozitën e Gjyqtarit për Kundërvajtje në Gjykatën Komunale në Prizren, në pritje të konfirmimit përfundimtar nga PSSP-ja. Në mbështetje të Nenit 1 (5) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/52 për Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtuftjeshëm "Rregullorja Nr. 2005/52), PSSP-ja ushtron pushtetin suprem lidhur me emërimin dhe largimin e gjyqtarëve nga posti i tyre.
13. Në tetor 2006, KGJK është informuar që Parashtruesi ka qenë i dënuar për disa vepra penale. Për këto arsye, KGJK-ja i kërkoi PSSP-së të shtyjë vendimin për emërimin e parashtruesit deri në një njoftim të ardhshëm për shkak se duhej të kryheshin hetime për këtë informatë.
14. Sipas informatës në fjalë, parashtruesi ishte dënuar për katër raste të ndryshme ndërmjet viteve 1986-2002. Tri nga dënimet janë fshirë nga dosja e tij por dënimi i katërt, i datës 15 janar 1986 për përdorim dhunë, që përbënte shkelje të Nenit 195 (1) të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (Aktgjykimi K. 317/85) dhe që parashihte dënimin në kohëzgjatje prej dy muajsh, nuk ishte fshirë.
15. Përveç këtij dënimi, Gjykata Komunale në Zagreb (Kroaci) në bazë të aktgjykimit të 15 tetorit 1986 i ka shqiptuar, siç pretendohet, parashtruesit një gjobë në shumë prej 50.000 dinarëve për shkak të veprës penale të shkeljes së Nenit 163 (1) dhe (3) të Kodit Penal të Kroacisë (K 537/85).
16. Më tutje del që Gjykata Komunale në Ferizaj e ka shpallur atë fajtor në vitin 2001 për veprën penale të shkakimit të lëndimit të lehtë trupor (Aktgjykimi P. Nr. 357/2001) dhe që i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej dy (2) muajsh.
17. Në aplikacionin e tij për pozitën e Gjyqtarit për Kundërvajtje në Prizren, Parashtruesi kishte deklaruar që ai nuk ishte dënuar më herët dhe që ishte i etnisë turke.
18. Në tetor 2006, një zyrtar konfirmimi i Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut vizitoi Komunën e Prizrenit për të kontrolluar shënimet e datëlindjes të parashtruesit dhe mësoi që prindërit e tij ishin me prejardhje shqiptare. Prandaj edhe ishte konstatuar që parashtruesi ishte me prejardhje shqiptare dhe jo turke.
19. Nëpërmjet letrës së 24 marsit 2007, KGJK njoftoi parashtruesin që, meqenëse ishte i dënuar për katër raste të ndryshme ndërmjet viteve 1986-2002 dhe për shkak se një prej këtyre dënimeve, ai i datës 15 janar 1986, nuk ishte fshirë, kishte tërhequr rekomandimin fillestar për emërimin e parashtruesit si gjyqtar në Gjykatën për Kundërvajtje në Prizren.
20. Nga dokumentet e parashtruara del se ka pasur një dozë konfuzioni në lidhje me të kaluarën penale të parashtruesit, që pjesërisht duke se është krijuar nga një gabim në përkthim të një prej këtyre dokumenteve. Domethënë, para se Kuvendi i Kosovës paraprakisht miratoi emërimin e parashtruesit në pozitën e gjyqtarit, raporti origjinal i hetimeve, i shkruar në gjuhën angleze, thekson dënimet e mëhershme penale. Megjithatë kur ky raport është përkthyer gjuhën shqipe dhe serbe, gabimisht është deklaruar që parashtruesi nuk është dënuar.



Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi pretendon shkeljen e të drejtave kushtetuese në vijim:

- Nenit 22 (1), (2) dhe (4) [Kapitulli II, Të Drejtat dhe Liritë Themelore, Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare];
- Nenit 24 (1) dhe (2) - [Barazia para Ligjit]
- Nenit 25 (1) - [E Drejta për Jetën]
- Nenit 41 (1) dhe (2) - [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]
- Nenit 49 (1) dhe (2) - [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]
- Nenit 54 - [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]
- Nenit 57 (1), (2) dhe (3) - [Kapitulli III, Të Drejtat e Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të Tyre, Parimet e Përgjithshme]
- Nenit 58 (2) - [Përgjegjësitë e Shtetit]
- Nenit 61 - [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike]
- Nenit 104 (5) - [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]
- Nenit 108 (3), (4) dhe (5) - [Kapitulli VII, Sistemi i Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës]

22. Për më shumë, parashtruesi ankohet që KGJK-ja ka vepruar në kundërshtim me Nenet 22 (2) dhe (4), 49 dhe 54 (1) të Kushtetutës duke mos emëruar atë në pozitën e gjyqtarit në Gjykatën për Kundërvajtje në Prizren edhe pse Kuvendi i Kosovës tashmë kishte miratuar rekomandimin e KGJK-së për emërimin e tij më 21 shtator 2006.

23. Përveç shkeljeve të pretenduara të të drejtave të tij kushtetuese, parashtruesi pretendon shkelje të ligjeve në vijim në ndërlidhje me shkeljet e të drejtave të tij kushtetuese:

- Neneve 9(2), 35(3), 37(1) dhe (2) dhe 77 të Ligjit (Nr. 02/L-28) për Procedurën Administrative;
- Nenit 1(a)(i) të Ligjit (Nr. 2003/12) për Qasje në Dokumentet Zyrtare dhe
- Neneve 2 (a), 4 (a) dhe (j) të Ligjit kundër Diskriminimit (Nr. 2004/3).

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

24. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata së pari duhet të kontrollojë nëse Parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe më tutje të specifikuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës.

25. Lidhur me këtë Kërkesë, Gjykata thekson që veprimet e KGJK-së, të cilat sipas parashtruesit kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese, kanë ndodhur në mars 2007. Kjo do të thotë se Kërkesa ka të bëjë me ngjarjet para 15 qershorit 2008 e që është

data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Rjedhimisht, Kërkesa është e paafatshme dhe e papajtueshme "ratione temporis" me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit (*shih Vendimin për Papranueshmëri, Lënda KI 25/09 Shefqet Haxhiu kundër Organizatës së punës "Industria e akumulatorëve" i datës 21 qershor 2010 dhe Blecic v. Kroaci, Kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i datës 29 korrik 2004*).

26. Prandaj rrjedh që Kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit, dhe Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOS

- I. TA REFUZOJ Kërkesën si të Papranueshme.
- II. Në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit, ky Vendim do t'iu komunikohet Palëve dhe do të shpallet në Gazetën Zyrtare.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

